

(Klubi Studentor)

faljen dhe magfiretin, sepse All-llahu ashtu siç është Falës dhe Mëshirues i Madh, është edhe Dënues i repretë:

„Është e vërtetë se goditja e Zotit tënd është e fortë.” (Buruxh: 12), dhe:

„Ja, kështu është ndëshkimi i Zotit tënd, kur dënon vendet që janë zullumqare. Vërtet ndëshkimi i Tij është i dhembshëm e i ashpër.” (Hud: 102).

Thotë Muhamedi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: **„Me të vërtetë All-llahu e lenë zullumqarin (të lirë) derisa ta merr atë, dhe kur ta merr nuk e lëshon më!”** (Mutefekun alejhi)

Janë tre shkaqe që e nxisin përtesën dhe dashurinë ndaj epshit:

1. Shikimi i epsheve në mënyrë të shpejtë; ngase shikimi e ngarkon mendjen dhe e detyron që të largohet nga përkujtimi i mëkatit, për arsye se sytë e epshit janë të verbër.

2. Neglizhenca në pendim. Sikur mendja e tij të ishte e shëndoshë, do të tërhiqte vërejtjen për pasojat e vonimit (të pendimit). Ndodh që ta kaplojë vdekja pa u penduar.

3. Shpresa për mëshirë. Thotë mëkatari: „All-llahu im është i Mëshirshëm”, kurse harron se „Ai është edhe Ndëshkues i ashpër”.


O ju të rinj, bëhuni më serioz, kthehuni te All-llahu juaj!

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



tyre ndaj meje. Më morën nëpër duart e tyre duke më përcjellur, derisa arrita në minber.”

Kjo është modesti dhe ky është moral!

„Dhe nga turpi i madh që kisha, nuk e dija se në cilën pjesë të Tokës gjindem dhe më mbuluan djersët.” U drejtua hoxha kah xhemati (populli, në këtë rast: të pranishmit në xhami) duke u thënë: 'Unë jam hoxha, mësuesi juaj, ndërsa ky është mësuesi im, për arsye se në ligjëratën e djeshme ju thashë se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] A'la, Talaka dhe Dhahere dhe asnjë nga ju nuk ishte më i ditur se unë dhe nuk më kundërshtuat. Kurse ky më përcolli mua deri në shtëpinë time dhe më tha mua kështu e kështu' dhe ia tregoi çdo gjë që ndodhi mes tij dhe nxënësit.

Dhe vazhdon më tutje:

„Dhe unë pendoem nga fjala që kam thënë dhe kthehem në të vërtetën. Kush më ka dëgjuar mua dhe është prezent sot, mos të më keqkuptojë, ndërsa kush mungon sot, të tjerët le t'ia përcjellin. Dhe All-llahu ju shpërbleftë me të mira!

Filloi të bëjë du'a për nxënësin dhe xhemati filluan të thonë Amin!”

U pendua tek All-llahu në shtëpinë e Tij para kërkuesit të diturisë dhe gjithashtu para njerëzve për atë që ka thënë.

Ka thënë Ibnul-Arabi duke shtuar në të: "Shikoni, All-llahu ju mëshiroftë në këtë

fe të qetë, të butë dhe të këndshme dhe e cila e respekton diturinë dhe pasuesin e saj. Një njeri me poste të larta e nderon një njeri të cilin as nuk e njeh dhe i cili ka ardhur nga një vend i largët. Pasojeni atë dhe do të udhëzoheni!”

Shikoni në besimin e sinqertë që gjeti vend në zemrën e këtij kërkuesi të diturisë, sesi u pajis me moral islam dhe duroi derisa e këshilloi gabuesin dhe e kumtoi ftesën që kishte me sinqeritet dhe përpikëri; dhe shikoni në hoxhën, zemra e të cilit ishte e mbushur me iman (besim), sesi e pranoi këshillën, u kthye në të vërtetën dhe u pendua te All-llahu para se t'i vijë vdekja.

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



(Klubi Studentor)

Enderuara rini!

Në qoftë se arrin moshën 40-të vjeçare, kush do të garantojë ty se do të posedosh fuqinë e tanishme edhe në atë moshë?

-I fortë në adhurimin e All-llahut [subhanehu ve tealja] në mënyrën më të plotë. A nuk mundet që biri 20-të, 30-të apo 40-të vjeç të goditet nga një sëmundje e cila ia dridhë të gjitha pjesët e trupit, e bën shok të shtratit dhe të burgosur të çarçafit të bardhë? A nuk mundet që biri 20-të, 30-të apo 40-të vjeç të pësojë aksidente të frikshme, nga të cilat mund të mbetet i palëvizshëm?!

Një nënë i thotë djalit të saj: „O djali im! Sikur të të mos kisha njohur si të vogël e të rritur, do të kisha menduar se ti ke shpikur një gjë shkatërruese ose ke bërë një mëkat shkatërrues kur po shoh se ç'farë po bën me vetveten".

Ia kthen djali: „Oj nëna ime! Ku ta di unë, ndoshta All-llahu

[subhanehu ve tealja] më ka vështruar duke qenë unë në disa mëkate dhe më ka urreyer në formën më të keqe e më ka thënë: 'Shko, se Unë nuk të fali ty!'".

Dënimi i atij që thotë: „Më vonë!"

I nderuar vëlla i ri dhe motër e re!

Kemi edhe një problem i cili nuk është i panjohur për ty, dhe ai është thënia „Më vonë," e cila nuk ka kufij të caktuar, është det i pafund dhe i obliguar që ta harrojë shokun e vet. Dhe vazhdon robi i Zotit me këtë neglizhencë derisa arrin në prag të vdekjes, ose deri në kohën kur të mbështillet me çarçafin e bardhë në varrin e tij, dhe kur i mbush të tridhjetat thotë: „Do të pendothem nesër", kur i mbush të dyzetat thotë: „Do të pendothem nesër!"... Dhe vazhdon kështu duke thënë "Nesër, nesër..."

Dhe çdo ditë që kalon i shtohet atij largimi nga All-llahu

[subhanehu ve tealja], largohet nga pendimi dhe nga ajo që të shpie në të.

Pra, shpejto! Thotë Hasan el-Basri, All-llahu e mëshiroftë: „Me të vërtetë një popull i kaploi mendimi se a do t'i falë All-llahu [subhanehu ve tealja], derisa u larguan nga kjo botë (vdiqën) pa u penduar dhe duke thënë ndonjëri prej tyre: 'Unë kam mendim të mirë për Zotin tim' (siç thonë shumica e rinisë tek ne. Nëse i thua për të kryer një adhurim ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja], të përgjigjet duke thënë: Nuk kam mundësi, por sidoqoftë unë e kam zemrën të bardhë. Edhe pse nuk kryen asnjë obligim ndaj Krijuesit, megjithatë i shkreti mendon se do të jetë nga të shpëtuarit]. Kështu ata e gënjejnë vetveten se nëse ke mendim të mirë, ashtu do ta kesh edhe veprën!"

O ju të rinj!

Të mjerët ju që lini anash pendimin dhe mbështeteni mbi

(Klubi Studentor)

Robërt të All-llahut!

Ejani së bashku ta mësojmë singëritetin dhe modestinë në pranimin e këshillës nga këshilluesi, kushdo qoftë ai! (nëse këshilla është sipas sunnetit ose është gabim që duhet përmirësuar). Vetëm se na kanë paraqitur dijetarët shembuj të rëndësishëm mbi pranimin e këshillës. Një shembull i tillë do të pasojë në vazhdim:

Një kërkues i diturisë (një nxënës) ka udhëtuar në vend të huaj që të prezantojë në ligjëratë në një rën prej xhamive, në të cilën ligjëronte një hoxhë i njohur. Xhamia ishte përplot njerëz, të cilët rregullisht merrnin pjesë në të. Ka ardhur ky, kërkuesi i diturisë, dhe është ulur në mexhlis (tubim) për të marrë dituri. Ibnul-Arabi el-Maliki e ka përmendur në librin e tij "Ahkamul-Kur'an" se Muhammed bin Kasim el-Uthmani i ka treguar duke thënë:

„Kam prezantuar në ligjëratën e shejhut (hoxhës) Ebi el-Fadl el-Xhevherij dhe ia kam paraqitur fjalët para njerëzve. Nga thëniet e tija të para ishin se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] *Talaka* (ka shkurrorëzuar gruan), *Dhahere* (i ka thënë gruas së tij se ti je si nëna ime) dhe *A'la* (është betuar se nuk do të kryejë marrëdhënie me gruan e tij për një kohë të caktuar). Ky, kërkuesi i diturisë, e ka dëgjuar një gjë të tillë, nuk është pajtuar me të, por nga

edukata e tij nuk e ka ndërprerë fjalën e hoxhës, mirëpo ka duruar për këtë dhe kur hoxha e ka kryer ligjëratën, ka dalë kërkuesi i diturisë dhe njerëzit e tjerë dhe e kanë përcjellur hoxhën e tyre nga xhamia deri në shtëpinë e tij. Pasi që janë ulur, hoxha e ka kuptuar gjendjen e djaloshtit. Kur shumica kanë filluar të largohen, hoxha iu drejtua djaloshtit: "Po të shoh si të huaj. Ke diçka për të shtuar?"

Iu përgjigj: "Po!"

Hoxha u tha të pranishmëve që t'i lënë vetëm këta të dy. Mbetën vetëm hoxha dhe kërkuesi i diturisë. Fillon djaloshti:

"Prezentova në ligjëratën tënde sot, ligjëratë plot me mirësi nga ti, kuptohet, mirësitë e Islamit në dituri dhe ligjëratat të diturisë-dhe mirësitë janë nga All-llahu [subhanehu ve tealja]. Nuk kërkove nga dikush tjetër pos All-llahut [subhanehu ve tealja] dhe të dëgjova duke thënë se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] *A'la*, dhe e the të vërtetën; të dëgjova duke thënë se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] *Talaka*, dhe prapë e fole të vërtetën. Mirëpo, gjithashtu the se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] ka bërë *Dhihar* (i ka thënë gruas së tij se ti je si nëna apo motra ime), dhe kjo nuk ka mundësi të ndodhë, sepse *Dhihari* është nga gjërat e urrejtura prej fjalëve dhe shpifjeve, dhe nuk është e mundur që këtë ta ketë bërë

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]"

Shiko vëlla në moralin e këshilluesit: ia përmend të mirat gabimtarit dhe pastaj e këshillon.

"Më ka përqafuar dhe më ka puthur në kokë duke më thënë: 'Unë pendothem nga kjo. All-llahu i dhashtë të mira atij që më mëson diçka të mirë!"

All-llahu ekber! Ku jemi ne në krahasim me këtë edukatë dhe këtë moral? Ç'ka na pengon neve që ta pranojmë këshillën? Shiko në kërkuesin e diturisë, në atë se si ka duruar dhe nuk ia ka përmirësuar gabimin hoxhës atëherë kur ai gaboi, por ka pritur derisa e ka përcjellur deri në shtëpi dhe derisa të gjithë u larguan, dhe kjo vazhdoi deri në orët e vona të natës. Ai e përcjelli emanetin - e këshilloi gabuesin në mënyrën që Islami e ka mësuar atë.

Dhe vazhdon nxënësi rrëfimin e ngjarjes:

"Pastaj jam ndarë nga ai (hoxha) dhe të nesërmen prapë shpejtova në ligjëratën e tij, mirëpo kuptova që ai kishte qenë aty para se unë të shkoja dhe ishte ulur mbi minber (vendi ku hoxha mban ligjëratë). Kur hyra në derën e xhamisë dhe kur ai më vërejti, thirri me zë shumë të lartë: 'Mirë se vjen, o mësuesi im! Lirojani rrugën mësuesit tim!' Dhe fytyrat e të pranishmëve u drejtuan kah unë dhe shkëlqenin sytë e